



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORÇË

VENDIM

Nr 83 Datë 15.08.2010

PËR
PËR DISA SHTESA NË PRIORITETET E INVESTIMEVE
PËR VITIN 2010

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban e Hartimit të Projekteve në Infrastrukturë dhe Drejtoria e Financës, "Për disa shtesa ne prioriteteve e investimeve per vitin 2010, mbështetur në :Ligji nr. 8652 dt.31.07.2000 " Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes vendore "neni 32 pika dh ,ligji 9936 dt.26.06.2008 " Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë " në ligjin nr. 10190 dt.26.11.2009" Për buxhetin e vitit 2010", Udhezimin Nr.1 date 21.01.2010 "Për zbatimin e buxhetit te vitit 2010 ", në VKB nr 20 datë 25.03.2010 "Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë për vitin 2010" dhe VKB nr. 17, date 12.03.2010 "Per percaktimin e prioriteteve te investimeve per vitin 2010" mbështetur në kompetencat që ka , si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të anëtarëve,

VENDOSI :

- I. Të miratojë shtesë në listën e prioriteteve të investimeve për vitin 2010 miratuar me vendim nr.17 datë 12.03.2010 edhe objektet si më poshtë vijon:
 1. Hapje pusi për furnizim me ujë teknologjik në kuadër të zbatimit të projektit të aplikimit të ngrohjes gjeotermike në "Kopështin nr. 14" me fondin prej: **1 594 260 lek**
- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Projekteve në Infrastrukturë, Drejtoria e Financës.
- III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

GJERGJI PENDAVINJI